



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE

VENDIM

Nr. 13, Datë 13.12.2010

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------|-------------|
| - Z. Besjan Pesha | Kryetar |
| - Znj. Anila Jani | Nënkryetare |
| - Znj. Ledina Mandia | Anëtare |

Në mbledhjen e tij të datës 13.12.2010, mori ne shqyrtim ankesën nr. prot. KMK 30, datë 4.11.2010, paraqitur nga Universiteti “Pavaresia” Vlore, për publicitetin e shfaqur në mediat lokale, te shkruara dhe vizive (si edhe në fletëpalosje, etj), nga ana e Universitetit Reald Vlore, ne lidhje me ofrimin e cikleve të studimit për shtate dege, si te akredituara dhe te licensuara.

Komisioni pas shqyrtimit të materialeve përkatëse dhe seancës dëgjimore të zhvilluar me përfaqësuesin e e Universitetit Reald, ne këtë mbledhje, si dhe përgjigjes se Ministrisë se Arsimit me shkrese nr. Prot 6995/1, date 17.11.2010,

VËREN SE:

Informacioni ne publicitetin ne fjale eshte i pavertete dhe per rrjedhoje edhe mashtrues, prandaj kjo praktike, referuar Ligjit nr. 9902, dt. 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve, eshte çorientues sipas:

- **pikës 1 te nenit 14:** “Një praktikë tregtare është çorientuese kur përmban informacion të rremë dhe për rrjedhojë është e pavërtetë”, dhe
- **pikës 1 të nenit 23:** “Publicitet çorientues kuptohet çdo publicitet, që në çdo mënyrë, përfshirë dhe paraqitjen e tij, mashtron ose ka mundësi të mashtrtojë personat të cilëve u adresohet, ose të cilët i prek dhe që, për shkak të natyrës mashtruese, ndikon ose ka mundësi të ndikojë në interesat ekonomikë të konsumatorit dhe, për këto arsye, dëmton ose ka mundësi të dëmtojë një konkurrent”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni mbështetur në nenin 52, pika 1 dhe 4 të Ligjit nr. 9902, dt. 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, si dhe në pikën 6 (a) dhe 31 të VKM nr. 1444, datë 22.10.2008

VENDOSI:

1. Universitetit Reald te ndaloje menjëherë shkeljen;
2. Te marre gjithë masat per mos përsëritjen e praktikave te tilla.

KRYETAR I KOMISIONIT

BESJAN PESHA